



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	04.08.2025
REFERENC-Ë:	25/3735/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Dino Mineral" Shpk Lipjan
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës , e ka shqyrtuar kërkesën për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga kompania e Juaj me nr.prot.: 25/3735/299/DMM, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi **Përfundim Procedure Administrative** të kërkesës së Kompanisë "Dino Mineral" Shpk Lipjan, për përpunimin, thërrmimin dhe seperimin e gruit gëlqeror të mermerizuar në Korishtë, Novobërdë.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the
General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

V E N D I M

Përfundimi i procedurës administrative i kërkesës së Kompanisë "Dino Mineral" Shpk Lipjan, për përpunimin, thërrmimin dhe seperimin e gruit gëlqeror të mermerizuar në Korishtë, Novobërdë.

A r s y e t i m

Komisioni për Vlerësim të Raporteve të VNM-së ka shqyrtuar kërkesën, Raportin e VNM-së, dokumentacionin e dorëzuar të Kompanisë "Dino Mineral" Shpk Lipjan, dhe gjatë shqyrtimit të Kërkesës, raportit të VNM-së si dhe dokumenteve përcjellëse të Kompanisë është konstatuar se mungon informata si në vijim:



Faqe 2 nga 3

- Pëlqimi i Komunës nuk ka qartësuar se a lejohet të zhvillohet aktiviteti për të cilin është aplikuar në ngastrën kadastrale nr. P-72403034-00212-0.

“Dino Mineral” Shpk Lipjan me datën 05.06.2025 i është dërguar njoftimi për plotësim dokumentacioni.

Kompania në fjalë nuk ka sjellë informatat shtesë brenda afatit të përcaktuar kohorë.

Bazuar në të lartcekuat, MMPHI merr **Vendim për Përfundim të Procedurës administrative** të kërkesës për paisje me Pëlqim Mjedisor për Kompaninë “Dino Mineral” Shpk Lipjan, për përpunimin, thërrmimin dhe seperimin e gruit gëlqeror të mermerizuar në Koretishtë, Komuna Novobërdë.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 25/3735/ - ZSP/ /25 datë: 04.08.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Komunës së Novobërdës
5. Kabinetit të Ministrit
6. Divizioni për komunikim me publikun
7. Arkivit të MMPHI

Izedin Bytyqi

UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI